



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 179, datë 29.09.2022

PËR
MIRATIMIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM DHE ANËTARIT TË BORDIT
DREJTUES TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT “INTERSIG VIG” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, të Rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës, Administratorit/Anëtarit të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Shoqëria “Intersig Vig” sh.a, ka depozituar vendimin e Këshillit Mbikëqyrës, datë 24.06.2022, për zgjatjen e afatit të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve si dhe vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, datë 26.07.2022, ndryshimin e pozicioneve të anëtarëve të bordit të drejtorëve dhe emërimin e zj. Fitnete Sulaj, Kryetare e Bordit Drejtues/Drejtor i Përgjithshëm i shoqërisë “Intersig Vig” sh.a.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e emërimit të zj. Fitnete Sulaj, në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë së sigurimit “Intersig VIG” sh.a., për një mandat 3-vjeçar.**
- 2. Miratimin e z. Gentian Sula në pozicionin e anëtarit të Bordit Drejtues të shoqërisë së sigurimit “Intersig VIG” sh.a., sipas afatit të përcaktuar në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë deri më datë 25.05.2024.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE